



## AMSHC • Ditar Nr. 14

Datë: 7.7.2017

*Prill / Maj / Qershor / 2017*

### Anëtarë të KKSHC-së në takim me përfaqësues nga Delegacioni Evropian në Shqipëri dhe Këshilli i Ministrave

Tiranë, 11 prill 2017



Anëtarët e shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) dhe përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) morën pjesë në një takim me përfaqësuesen e Delegacionit Evropian në Shqipëri, znj. Enkelejda Bregu Lopari dhe të Këshillit të Ministrave, z. Ergis Sefa, i cili u mbajt në ambjentet e EU Info Center Tiranë.

Në fjalën e hapjes, znj. Enkelejda Bregu Lopari prezantoi arsyet e realizimit të këtij takimi dhe ftoi të pranishmit të prezantojnë problematikat e tyre, vështirësitë por

edhe mënyrën e zgjidhjes në funksion të gjetjes dhe ofrimit të ndihmës nga ana e Delegacionit, të cilët kanë shprehur interesim të veçantë.

Gjithashtu u shpreh se nga ana e Delegacionit, do të organizohen sesione informuese me temë: Dialogu Politik dhe Financimi i organizatave të shoqërisë civile.

Anëtarët pjesëmarrës diskutuan dhe parashtruan problematikat e hasura dhe zgjidhjet e mundshme të tyre si edhe u shprehën të gatshëm për të bashkëpunuar me zyrën e Delegacionit

Europian për ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm të nevojshëm.

Më tej, fjalën e mori përfaqësuesi nga Këshilli i Ministrave, z. Ergis Sefa, ku u shpreh se iniciativat e Këshillit do të jenë të mbështetura edhe nga Qeveria Shqiptare.

Gjithashtu prezantoi edhe hapat e marra mbi programin specifik për shoqërinë civile dhe organizimin e trajnimeve për këtë sektor në përgjithësi dhe për përfaqësinë e shoqërisë civile pranë Këshillit në veçanti.



## Fondacioni “Fundjavë ndryshe” çel degët e saj në Durrës e Vlorë

11 prill 2017



Për të qenë edhe më pranë shtresave në nevojë, familjeve me probleme të mëdha sociale dhe ekonomike, Fondacioni “Fundjavë ndryshe” çel degët e saj në Durrës e Vlorë.

Me motot, “Bamirësia nuk të varfëron” dhe “Nga shqiptarët për shqiptarët”, fondacioni synon hapjen e sa më shumë degëve në gjithë vendin, për të vijuar misionin e nisur prej kohësh.



Zgjerimi i aktivitetit të Fondacionit “Fundjavë Ndryshe”, konsiston pikërisht në nevojën për ekzistencën e një infrastrukture që mundëson nevojën e bamirësit për të dhuruar tek njerëzit në nevojë dhe që mundëson lidhjen direkt midis dhuruesit dhe përfituesit në zonat më të ekspozuara nga fenomeni i varfërisë ekstreme në vend.



Ky projekt gjithashtu synon përkrahjen e programeve të veprimtarive humanitare, ofrimin e shërbimeve falas dhe kujdesin për të gjitha moshat në rang Republike me qëllim, mirëqenien, dinjitetin dhe sigurimin e cilësisë së jetës. Promovimi i solidaritetit dhe vullnetarizmit është tjetër synim i projektit dhe me këtë rast shumë të rinj iu bashkuan grupit të vullnetarëve të “Fundjavë Ndryshe”.



## Forumi Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve

Tiranë, 26 prill 2017



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) mori pjesë në Forumin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, për të diskutuar rreth gjetjeve dhe rekomandimeve të vlerësimit me panelin e përbërë nga aktorë qendrorë, vendorë si dhe nga trupi i donatorëve të huaj.

Ky forum kombëtar u organizua nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri në bashkëpunim me Institutin e Kërkimeve Urbane (URI), në kuadër të përfundimit të projektit “Vlerësimi i Mangësive në Zbatimin e Strategjisë dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve”, si pjesë e programit ACHIEVE me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe u mbajt në ambientet e hotel “The Plaza Tirana”.

Objektivi kryesor i këtij projekti ka qenë sigurimi i asistencës në nivel qendror dhe vendor për përmirësimin e procesit të zbatimit të strategjisë dhe planit kombëtar të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe të rrisë ndërgjegjësimin e banoreve rreth përfitimeve ekonomike dhe mjedisore si rrjedhojë e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Për të arritur këto objektiva Institutin e Kërkimeve Urbane (URI) me mbështetjen e REC Shqipëri ka përfunduar dokumentin mbi vlerësimin e legjislacionit Shqiptar duke e krahasuar atë me legjislacionin Evropian në fushën e menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane si dhe identifikimin e nivelit të zbatueshmërisë së këtij legjislacioni.



## Projekti fotografik “Gjenerata A”

Tiranë, 26 prill 2017



Përfaqësues i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) mori pjesë në eventin e organizuar në kuadër të Projektit fotografik “Gjenerata A” i Artistit Z. Julius Eb në bashkëpunim me Linjën Kombëtare kundër Dhunës në Familje dhe Linjën e Këshillimit për Burra dhe Djem, i cili u mbajt në ambjentet e Galerisë Kombëtare të Arteve, Tiranë.



Të pranishmit në event i përshëndeti z. Artan Shabani – Drejtor i Galerisë Kombëtare të Arteve, znj. Dewi Van de Weerd – Ambasadore e Mbretërisë së Hollandës, z. Erion Veliaj – Kryetar i Bashkisë së Tiranës dhe znj. Iris Luarasi – Linja Kombëtare kundër Dhunës në Familje si dhe anëtare e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC).

Në fjalën e tij autori artist Julius Eb, theksoi se Projekti fotografik “Gjenerata A” reflekton perceptimin e tij për identitetin, vlerat, bukurinë, por dhe anën e vështirë të transformimit.

Se fotografia kontemporane ofron një sfidë kontrastuese me artin e Realizmit Socialist, i cili portretizon vizionin e udhëheqjes së asaj kohe dhe jetën e përditshme.

Znj. Iris Luarasi theksoi se në bashkëpunim me Galerinë Kombëtare të Arteve kemi nxjerrë nga Fondi i Galerisë disa punime të Realizmit

Socialist për të parë dhe shtuar diskutimet për rolet dhe ndryshimet gjinore në kohërat e shkuara dhe për t’i sjellë ato në një reflektim për të sotmen nëpërmjet workshopeve që do të organizohen në të ardhmen me të rinjtë tanë.



Në mbyllje të eventit organizatorët falenderuan edhe një herë mbështetësit e projektit që ishin Ambasada e Mbretërisë së Hollandës, Bashkia e Tiranës, Galeria Kombëtare e Arteve si dhe IAMANEH Schweiz (Suisse Gesundheit für Frauen und KinderSanté pour femmes et en fants).



## Qendra “Res Publica” zhvillon trajnim për të drejtat që burojnë nga Ligji “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

Tiranë, 28 prill 2017



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) mori pjesë në trajnimin për të drejtat që burojnë nga Ligji Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, i organizuar nga Qendra “Res Publica” me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED) në kuadër të programit “Promovimi i pjesëmarrjes qytetare në advokimin legjislativ”. Trajnimi u mbajt në ambjentet e “Tirana International Hotel” dhe morën pjesë organizata dhe aktivistë të shoqërisë civile.

Gjatë trajnimit u bë prezantimi i Ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe komentari; prezantimi i rasteve të veçanta të konsultimit publik; prezantimi i disa të dhënave krahasimore mbi zbatimin e ligjit gjatë dy viteve të para që nga hyrja në fuqi e Ligjit si dhe u bë shpërndarja e Komentarit të këtij ligji për të pranishmit.



## AMSHC fton aktivistë për pjesëmarrje në Tirana Gay (P)Ride në kuadër të “Javës së Diversitetit - kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë”

Tiranë, 13 - 19 maj 2017



Aleanca LGBT, Pro LGBT, Ambasada PINK dhe organizata në mbrojtje të të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri njoftuan gjithë personat e interesuar për t’iu bashkuar dhe në një formë apo në një tjetër, të jepnin kontributin e tyre aktivite dhe në luftën kundër homofobisë në Shqipëri.

Edhe Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mbështeti dhe njoftoi publikisht palët e interesuara të mbështesin moralisht dhe me pjesëmarrjen e tyre në këto aktivite.



“Java kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë” nisi me paradën e 6-të me biçikleta “Tirana Gay (P)Ride” dhe vazhdoi me aktivite të tjera deri në 19 maj 2017.



Mesazhi i paradës këtë vit është për lirinë dhe për dinjitetin e individëve, pavarësisht orientimit seksual apo identitetit gjinor.

Në ditët në vijim u zhvilluan: Takime pranë qendrës së Aleancës LGBT me aktivistë nga Kosova, Serbia dhe Maqedonia; Ndarja e çmimeve “Aleati i Vitit”, ku u shpreh mirënjohja për mbështetjen që i është dhënë komunitetit LGBT gjatë vitit; Një ekspozitë me punime të anëtarëve dhe mbështetësve të komunitetit LGBTI tek Libr’Aria - Parku i Liqenit; Konferenca “Aksesi në Drejtësi” në hotel Sheraton; Aktiviteti “Të flasim hapur për të drejtat e LGBTI”, i mbajtur në Qendrën për Hapje dhe Dialog (COD); Mbrëmje Gala e Bamirësisë “Embrace Diversity, Support Progress” etj..





## Trajnim mbi “Të Drejtën e Informimit dhe Konsultimit Publik dhe rolin e organizatave të shoqërisë civile (OShC) në proces”

Tiranë, 24 maj 2017

Njësia e Kërkimit dhe Zhvillimit të Politikave, në Kryeministri, në bashkëpunim me si edhe Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), organizuan në “Qendrën për Hapje dhe Dialog, COD”, pranë Kryeministrit, trajnimin mbi “Të Drejtën e Informimit dhe Konsultimit Publik dhe rolin e organizatave të shoqërisë civile (OShC) në proces”.



Ky është cikli i parë i aktiviteteve me karakter rritje kapaciteteve që Njësia e Kërkimit dhe Zhvillimit të Politikave, Kryeministri, së bashku me AMShC, planifikojnë të ndërmarrin për krijimin e një mjedisi mundësues për shoqërinë civile.



Trajnimi u krye nga znj. Ardita Shehaj dhe znj. Amarilda Xhyheri, përfaqësuese të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave personale. Trajnimi u fokusua në njohjen e pjesëmarrësve me ligjet për të drejtën e informimit si dhe atë të njoftimit dhe konsultimit publik.


Më pas u prezantuan mundësi se si OShC mund të përdorin elementë të ligjeve për të kërkuar informacion mbi politikat publike dhe/ose të përfshihen në proceset e konsultimit të një politike të re që institucionet shtetërore kërkojnë të ndërmarrin.

Ky trajnim u ofrua për anëtarët nga OShC të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile (KKShC) në vijim të rritjes së kapaciteteve të KKShC-së për të kryer sa më mirë punën parashikuar nga Ligji 119/2015.

Në këtë trajnim morën pjesë edhe përfaqësues nga AMShC dhe disa organizata jo-fitimprurëse.

Komisioneri i të Drejtës së Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale është një organ kolegjal, i cili këshillon Këshillin e Ministrave lidhur me politikat publike që impaktojnë veprimtarinë e shoqërisë civile.

Njësia e Kërkimit dhe Zhvillimit të Politikave është organi i ngarkuar nga Këshilli i Ministrave, me Vendimin 459/2015, për të koordinuar dhe bashkërenduar procesin e krijimit të një mjedisi mundësues për shoqërinë civile.





## Takim hapës për “Programin Rajonal Mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor” (ReLOaD)

Tiranë, 26 maj 2017



Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), z. Andi Kananaj merr pjesë në takimin hapës për “Programin Rajonal Mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor” (ReLOaD), program i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në partneritet me AMSHC-në, njësi të pushtetit vendor dhe organizata të shoqërisë civile.

Të pranishëm ishin përfaqësues nga Seksioni Politik, Ekonomik dhe Informativ të BE-së në Shqipëri, Koordinatori i përhershëm i OKB-së dhe përfaqësues i përhershëm i UNDP në Shqipëri, organizata të shoqërisë civile etj.

Në fjalën e tij, z. Kananaj theksoi rëndësinë e këtij projekti, objektivi i të cilit është të forcojë demokracinë pjesëmarrëse dhe procesin e integritimit në BE në vendet e Ballkanit Perëndimor, nëpërmjet fuqizimit të shoqërisë civile.

Në vijim të takimit u prezantua “Programi Rajonal Mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor” (ReLOaD) nga znj. Eglantina Gollaj, Menaxhere e Projektit ReLOaD.





## AMSHC merr pjesë në zhvillimin e aktiviteteve të Qendrës së Studimeve dhe Zhvillimeve (QSZH), në kuadër të Thirrjes 10

1 - 2 qershor 2017

Përfaqësues nga AMSHC, në zbatim të kontratës së financimit me Grant në Thirrjen Nr. 10, ndërmjet Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) dhe Qendrës së Studimeve dhe Zhvillimeve (QSZH) dhe në kuadër të aktiviteteve të parashikuara, realizuan takimin e radhës me këtë subjekt.

Realizimi i eventit u mundësua në qytetin e Kuçovës dhe Beratit, ku në zbatim të projektit me titull "Integrimi social i të rinjëve dhe grave, në zonat rurale në qytetin e Kuçoves" u shpërndanë materiale informuese në funksion të sensibilizimit të mbarë shoqërisë për të drejtat e këtyre dy kategorive.

Impakti i projektit ishte i madh referuar pjesëmarrjes së vullnetarëve në këtë aktivitet, por edhe i qytetarëve të cilët shprehën interesin e tyre për marrjen e këtij informacioni.



Agjencia për Mbështetjen  
e Shoqërisë Civile

## AMSHC organizon takime konsultative me aktorë të shoqërisë civile

Qershor - Korrik 2017

Në zbatim të Ligjit Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), ka ndërmarrë iniciativën për të realizuar takime konsultative me aktorë të shoqërisë civile përgjatë muajve Qershor – Korrik 2017.

Këto takime janë territorialisht gjithëpërfshirëse duke mundësuar edhe dëgjim të orientimeve të pjesëmarrësve mbi mënyrën dhe organizimin e proceseve administrative dhe vendimmarrëse të Institucionit.

Gjithashtu u zhvilluan edhe monitorime në terren të projekteve të financuara nga AMSHC.

Përgjatë muajit qershor janë mbajtur dy takime konsultative, më datë 22 qershor 2017 në qytetin e Kukësit dhe më 29 qershor 2017 në qytetin e Gjirokastrës.

Takimet e radhës janë më datë 5 korrik 2017 në qytetin e Pogradecit dhe takimi përmbyllës më 15 korrik 2017 në Tiranë.





## Dita Ndërkombëtare e Refugjatëve – SHQIPËRI Çelet ekspozita fotografike TRA(S)GUARDI

Tiranë, 29 qershor 2017

Përfaqësues nga AMSHC mori pjesë në eventin artistik të organizuar nga GUS Albania, në kuadër të "Edu në Re dhe Netë në Re" për Ditën Ndërkombëtare të Refugjatëve.




Më shumë se një ekspozitë, është një rrëfim fotografik. Një projekt komunikues përmes të parit, i cili filloi nga një ide, nga një vëzhgim dhe u konkretizua në momentin e shkrepjes.



Një koleksion i përgatitur nga operatorët e Gus-it, jo nga fotografë profesionistë: këta mjeshtra të fotografisë, që gjatë punës, kanë analizuar dhe deshifruar forma të kulturës dinamike, duke u fokusuar në aspektet sociale dhe antropologjike të jetës së përditshme, me qëllimin e vetëm për të ruajtur kujtimet.

GUS "Grupi Solidariteti njerëzor" Guido Puletti filloi të veprojë në dhjetor 1993, kur Evropa ishte ende duke u përballur me konfliktin e parë rajonal, atë të pas rënies së murit të Berlinit.

Aktiviteti artistik u pasua nga një koncert muzikor të Grupit "TRACK N TRAIN".





## Forumi qytetar “Forcimi i Zërit Qytetar përmes Mekanizmave me Pjesëmarrje”

Tiranë, 30 qershor 2017



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) mori pjesë në forumin për promovimin e praktikave të mira për angazhimin qytetar.

“Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim” në kuadër të projektit “Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen”, të mbështetur nga UN WOMEN, Qeveria e Suedisë dhe Projekti i USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP), organizoi forumin qytetar “Forcimi i Zërit Qytetar përmes Mekanizmave me Pjesëmarrje”.

Forumi promovoi rëndësinë e nxitjes së angazhimit qytetar në nivel vendor si një mjet për të mbështetur qeverisjen e mirë, demokracinë vendore dhe fuqizimin e komunitetit përmes pjesëmarrjes, përgjegjshmërisë dhe vendimmarrjes së informuar.

